



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
ZV. KRYETARI

Nr. 724/2 Prot.

Pukë, më 29 / 04 2026

Lënda: Kërkesë për pranim projekt-vendimi në rendin e ditës.

Drejtuar: Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, Pukë

Z. Gjon GJOKA

Z. Kryetar i Këshillit të Bashkisë Pukë!


Në zbatim të rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë, kërkoj mirëkuptimin tuaj për pranimin në rendin e ditës të mbledhjes së dates 30.04.2026 të projektvendimit nr. 01, datë 29.04.2026;

“Për miratimin e vendosjes së një barriere kontrolli (trau) në rrugën rurale të lagjes Mashën, Njësia Administrative LUF-QERRET, bashkia Pukë

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

KRYETARI

Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Zv.KRYETARI

Nr. 721 prot.

Pukë, më 29/04/ 2026.

PROJEKT VENDIM

NR. 1 Datë: 29/04/2026

PER

MIRATIMIN E VENDOSJES SË NJË BARRIERE KONTROLLI (TRAU) NË RRUGËN RURALE TË LAGJES MASHËN, NJESIA ADMINISTRATIVE QERRET, BASHKIA PUKË.

Në mbështetje të ligjit 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 23 pika 4 që lidhet me funksionet e Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ligjit 8378 dt.22.7.1998 " Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"i ndryshuar, ligji 107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së banorëve të lagjes Mashën, Njesia Administrative Qerret, Bashkia Pukë, në funksion të rritjes së sigurisë publike dhe të pronave të tyre, Këshilli I Bashkisë Pukë, me propozim të kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë kufizimin e qarkullimit të mjeteve në segmentin rrugor të lagjes Mashën duke e klasifikuar si rrugë me akses të kufizuar, kryesisht për banorët e zonës.
2. Të lejojë vendosjen e një barriere kontrolli (trau), me kusht që të mos bllokojë plotësisht qarkullimin public, të garantojë akses të menjëhershëm për shërbimet emergjente si Sherbimin Zjarrfikës, Sherbimin Shendetësor, Sherbimin Pyjor dhe struktura të tjera shtetërore, të respektojë standartet e sigurisë rrugore
3. Të përcaktojë se administrimi i aksesit hapja dhe mbyllja të kryhet në mënyrë që të mos pengohet kalimi i personave apo mjeteve me interes të ligjshëm.
4. Ngarkohen Drejtoria e Sherbimeve, Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015 datë.17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 55, pika 6.

Paraqiten projektin

Zv.Kryetari i Bashkisë

Ferit RINGAJ

Juristi

Aida SINANI

Kryetari i Bashkisë

Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Zv.KRYETARI

Nr. 72/1 prot.

Pukë, më 29/04/2026.

Relacion

Mbi

PROJEKT VENDIMIN

NR. 1 Datë. 29/04/2026

PER

MIRATIMIN E VENDOSJES SË NJË BARRIERE KONTROLLI (TRAU) NË RRUGËN
RURALE TË LAGJES MASHËN, NJESIA ADMINISTRATIVE QERRET, BASHKIA PUKË.

Të nderuar anëtarë të Keshillit të Bashkiak,

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Bashkisë Pukë, në mbështetje të ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 23 pika 4 që lidhe me funksionet e Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ligjit 8378 dt.22.7.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”i ndryshuar, ”, ligji 107/2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

Banorët e lagjes Mashën, rreth 30 kryefamiljarë kanë depozituar kërkesën e tyre me nr.27/3 dt.27.03.2026, drejtuar Kryetarit të Bashkisë ku kërkojnë vendosjen e një trau në hyrje të rrugës së lagjes së tyre me arsyetimet e tyre që gjatë viteve të fundit janë vënë re shumë dëmtime kryesisht në infrastrukturën energjitike, dëmtime në pyjet e zonës, raste të vjedhjeve në banesat e tyre, hyrje të pautorizuara të mjeteve të rënda që kanë shtuar dëmtime të relievit dhe rrugës.

Kjo rrugë është e ndërtuar në vitin 1982 dhe lidh rrugën nacionale me lagjen Mashën. Sipas dokumentacionit përkatës (hartat e viteve 1935, 1978,1986, adresari I vitit 2010 dhe Plani I Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Pukë, miratuar në vitin 2018) kjo rrugë paraqitet si një rrugë pa dalje (rrugë qorre)e cila nuk shërben si aks lidhës ndërmjet njësive të tjera territoriale, por vetëm për aksesin e banorëve të kësaj lagjeje.

Kërkesa për vendosjen e traut përbën një masë proporcionale të arsyeshme e cial synon:

- Parandalimin e hyrjeve të personave të pautorizuar.
- Mbrojtjen e pronës private dhe investimeve të banorëve
- Mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullotave nga shfrytëzimi i paligjshëm
- Uljen e rrezikut nga zjarret e qëllimshme.
- Rritjen e sigurisë në zonë.

Referuar arsyetimeve të mësipërme i rekomandojmë këshillit marrjen e vendimit për vendosje e një barriere (Trau) në hyrje të rrugës së Lagjes Mashën, ku nga vendosja e saj nuk do ketë asnjë shpenzim nga buxheti i Bashkisë. Do të garantohet akses i menjehershëm dhe i pakushtëzuar për

sherbimet publike emergjente, përfshirë Policinë e Shtetit, Sherbimin e urgjencës Mjekësore, Sherbimin zjarrfikës, Sherbimin pyjor dhe strukturat e Bashkisë.

Kerkesa e banorëve është e shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës, konkretisht:

- 1-Lista e firmave të banorëve
- 2-Foto
- 3-Dokument Pronësie datë.20 Maj 1873
- 4-Fragment harte e vitit 1935
- 5-Fragment harte e vitit 1978
- 6-Fragment harte e vitit 1986
- 7-Fragment adresari e vitit 2010
- 8-Plani I Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Pukë (2018)
- 9-Harta e infrastrukturës Rrugore sipas PPV-së
- 10-Vendimi i Këshillit Kombëtar i Territorit nr.1 date,20.06.2018

Për sa më sipër , e vlerësojmë se miratimi nga an juaj e këtij projektvendimi është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me funksionet dhe përgjegjësitë e bashkisë, si dhe në interesin e komunitetit local të kësaj zone.

Përgatiti relacionin
Zv.kryetari i Bashkisë
Ferit Ringaj

